



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

RAPORT
(Përfundimtar)

PËR

MBIKËQYRJEN E LIGJSHMËRISË NË ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT CIVIL

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë, Shtator 2018

RAPORT

Për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Hyrje

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara, në nenin 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, në zbatim të planit vjetor të mbikëqyrjes dhe të Vendimit nr. 36, datë 17.04.2018, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Komisioni Qendror i Zgjedhjeve”*, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, në institucionin Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organ publik, i pavarur, i krijuar me ligj, në mbështetje të nenit 153, të Kushtetutës dhe ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, *“Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar. Në zbatim të nenit 10, të ligjit nr. 9584, datë 17.07.2006, *“Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”*, struktura dhe organika e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve miratohet me vendim të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Institucioni i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve përbëhet nga Komisioni, i cili është organi kolegjial vendimmarrës, si dhe nga Sekretariati. Referuar ligjit të posaçëm, në bazë të të cilit funksionon Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, konkretisht nenit 25, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, *“Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, nëpunësit e Sekretariatit gëzojnë statusin e nëpunësit civil. Ky regjim juridik, ka ekzistuar edhe para momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, pasi mënyra e fillimit dhe mbarimit të marrëdhënieve të punës, për punonjësit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, janë rregulluar me ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999, *“Statusi i nëpunësit civil”*, i ndryshuar.

Në bazë të programit të mbikëqyrjes nr. 416/1 prot., datë 17.04.2018, të miratuar nga Komisioneri dhe njoftuar institucionit me shkresën nr. 416/2 prot., datë 17.04.2018, *“Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Komisioni Qendror i Zgjedhjeve”*, grupi i punës u paraqit në institucion në datën 23.04.2018.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin të gjitha institutet e ligjit për nëpunësin civil, gjatë procesit të administrimit të shërbimit civil.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm në institucion, grupi i punës i përbërë nga Ledina Zhupa dhe Matilda Idrizaj, nën drejtimin e Drejtorit të Mbikëqyrjes, Altin Shumeli, përpunoi të dhënat dhe përgatiti projekt raportin e mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Me shkresën nr. 416/4, prot. datë 31.07.2018, të Komisionerit, “Dërgohet projektraporiti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”, projektraporiti i hartuar nga grupi i punës, i është dërguar për njohje institucionit të mbikëqyrur, duke i lënë 15 ditë kohë për të paraqitur observacionet.

Subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me përmbajtjen e materialit, nëpërmjet shkresës nr. 1137/1 prot., datë 07.09.2018, të Kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, “Dërgohet kopja e projektraporitit për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”, ka dërguar projektraporitin e nënshkruar pa paraqitur observacione, duke u shprehur dakord në lidhje me gjetjet e grupit të mbikëqyrjes, të pasqyruara në të.

Në këto rrethana, duke u konsideruar e plotësuar kërkesa për zbatimin e procedurës në këtë rast, nga ana e grupit të mbikëqyrjes u hartua dhe raporti përfundimtar i mbikëqyrjes, sipas përmbajtjes që do të analizohet në vijim.

Qëllimi i mbikëqyrjes

Qëllimi i realizimit të mbikëqyrjes është:

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.
- Paraqitja para përgjegjësve për administrimin e shërbimit civil, njësisë së burimeve njerëzore dhe titullarit të institucionit, e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil.
- Paralajmërimin e institucionit dhe lënien e detyrave për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Objekti i mbikëqyrjes

1. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë të institucionit në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.
2. Plotësimi i kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë, që do të verifikohet në këto aspekte:
 - Përfshirja e funksionit në shërbimin civil në përputhje me përshkrimin e punës dhe detyrat që realizon ky funksion.
 - Punonjësit ekzistues që janë punësuar në pozicione të shërbimit civil sipas këtij ligji, që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, nëpërmjet procedurave të ngjashme me dispozitat e ligjit të mëparshëm, nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit Civil”, apo për një periudhë jo më të vogël se 1 vit.

- NËpunësit ekzistues që janë të punësuar në pozicione, pjesë të shërbimit civil, sipas këtij ligji, pa kaluar më parë në procedurë formale konkurruese ose që kanë më pak se një vit në këto pozicione pune.
 - Rastet e refuzimit të deklarimit të statusit të punësimit.
 - Si është dokumentuar procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse, në rastin e deklarimit të statusit të punësimit të punonjësve.
 - Si është dokumentuar në dosjen e personelit procedura e verifikimit dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nga njësia përgjegjëse, kërkesat e përgjithshme, kërkesat e posaçme, procedura e rekrutimit, akti i emërimit, etj.
3. Respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës sipas formatit të përcaktuar nga ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij, që do të verifikohet në këto aspekte:
- Si është zbatuar procedura e hartimit të përshkrimit të punës dhe formati i miratuar me aktin nënligjor përkatës.
 - Punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë kërkesat e përgjithshme të përcaktuara në nenin 21, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.
 - Punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë kërkesat e posaçme, sipas formularit të përshkrimit të punës.
4. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil.
5. Rastet e rekrutimeve, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.
6. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës (*detyrimet e nëpunësit dhe procedura e vendimmarrjes në përfundim të kësaj periudhe*).
7. Transferimi i përkohshëm dhe transferimi i përhershëm dhe si janë respektuar kërkesat ligjore në këto raste (*ristrukturimi dhe ngritja e komisionit përkatës, aktet që materializojnë procesin, si dhe rastet e tjera të transferimit*).
8. Pezullimi nga shërbimi civil, sipas rasteve të parashikuara në ligj dhe si janë zbatuar kërkesat ligjore gjatë procedurës së zhvilluar në këto raste.
9. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore (*kërkesa për fillimin e ecurisë, ngritja e Komisionit të Përhershëm*).
10. Vlerësimi i rezultateve në punë dhe si është zhvilluar ky proces pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar. Si materializohet

procedura e vlerësimit dhe detyrimet ligjore që ligji i ka vendosur aktorëve të këtij procesi gjatë vitit të vlerësimit (*Zyrtari Raportues, Zyrtari Kundërfirmues*).

11. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirimit nga shërbimi civil: si rezultat i dorëheqjes dhe për shkak të ligjit.
12. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (*njësia përgjegjëse*), gjatë punës për zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.

Metodologjia e mbikëqyrjes

Grupi i mbikëqyrjes ka zgjedhur si metodë pune verifikimin e dokumentacionit që ka lidhje me objektin e mbikëqyrjes, i cili administrohet në dosjet individuale të personelit, në arkivin e institucionit si dhe në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, për çdo nëpunës të emëruar në pozicion pune pjesë e shërbimit civil.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, grupi i punës ndërmori veprimet e mëposhtme:

- Fillimisht u realizua një takim me Sekretarin e Përgjithshëm të institucionit, ***** dhe me Drejtorin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, *****, gjatë të cilit u diskutua me objektin dhe drejtimet e mbikëqyrjes, si dhe u ra dakord në lidhje me dokumentacionin shkresor që duhej të vihej në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes për verifikim.
- U verifikuan pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil, sipas organigramës dhe strukturës, për institucionin Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.
- U verifikuan procedurat e rekrutimit dhe përmbajtja e dosjeve individuale të çdo nëpunësi civil, si dhe çdo e dhënë tjetër e kërkuar nga ligji për plotësimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil.
- U verifikuan të dhënat profesionale, si dhe të dhënat e tjera për marrëdhëniet e punës të çdo nëpunësi civil, lidhur me përmbushjen e kërkesave të posaçme të pozicionit të punës si niveli arsimor, përvoja në punë, e tjera.
- U administrua dokumentacioni i kërkuar, ku përfshihen listë prezenca dhe listë – pagesa e nëpunësve civilë për periudhën Shkurt 2014 dhe Mars 2018.
- U verifikua ligjshmëria e gjithë akteve të deklarimit të statusit të nëpunësit civil lëshuar nga njësia e burimeve njerëzore, për të gjithë nëpunësit e institucionit në mbikëqyrje

Konstatimet janë të materializuara si tabela më vete (Tabela 1, Tabela 2), të cilat janë pjesë e këtij projekt raporti.

Përmbajtja e projekt raportit:

- I. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me statusin e

nëpunësve dhe punonjësve aktualë të institucionit në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.

1. Situata e administrimit të burimeve njerëzore në momentin e mbikëqyrjes.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si institucion publik i pavarur, ka hyrë në skemën e administrimit të shërbimit civil me ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”, (i shfuqizuar) dhe ka ruajtur të njëjtin status edhe me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, pasi në nenin 2 të tij, përcaktohet se, ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, *institucion të pavarur* apo njësi të qeverisjes vendore.

Në momentin e mbikëqyrjes, institucioni Komisioni Qendror i Zgjedhjeve funksionon mbi bazën e strukturës organizative të miratuar me vendimin nr. 168, datë 24.04.2017, të Kuvendit, “*Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e KQZ-së nr. 110, datë 12.09.2002 “Për miratimin e strukturës, organikën dhe numrin e punonjësve të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”*”. Sipas kësaj strukture, institucioni i mbikëqyrur, përbëhet nga Komisioni dhe Sekretariati. Në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “*Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, Komisioni është organ kolegjal vendimmarrës dhe nuk i nënshtrohet rregullimit juridik të ligjit për shërbimin civil.

Në referencë të nenit 25, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “*Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, nëpunësit e Sekretariatit gëzojnë statusin e nëpunësit civil. Sekretariati drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm, i cili klasifikohet si pozicion pjesë e shërbimit civil, por në kuptim të nenit 25, pika 2, të po këtij ligji, ky i fundit zgjidhet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Në zbatim të nenit 32, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe të vendimit nr. 118, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për procedurat e emërimit rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së*”, i ndryshuar, rezulton se, në institucionin e mbikëqyrur, është vendosur të lejohet pjesëmarrja e kandidatëve nga jashtë shërbimit civil, për pozicionin “*Sekretar i Përgjithshëm*”.(Rasti do të trajtohet në kapitullin nr. IV, të këtij projekt raporti).

Bazuar në strukturën organizative aktuale, institucioni i mbikëqyrur ka gjithsej **71** pozicione të miratuara, nga të cilat **45 pozicione pune janë pjesë e shërbimit civil.**

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, të ndryshuar, pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil në këtë institucion, paraqiten në këtë raport:

- Nëpunës civilë të kategorisë së lartë drejtuese është **1** pozicion pune ose rreth **2 %** të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, e cila i përket pozicionit “*Sekretar i Përgjithshëm*”;

- Nëpunës civilë të kategorisë së mesme drejtuese janë **7** pozicione pune ose rreth **16%** të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin pozicionit “*Drejtor*”;
- Nëpunës civilë të kategorisë së ulët drejtuese janë **6** pozicione pune ose rreth **14 %** të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin pozicionit “*Përgjegjës Sektori*”;
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive janë **31** pozicione pune ose rreth **68 %** të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, nga të cilat **5** i përkasin pozicionin “*Inspektor*” dhe **26** i përkasin pozicionit “*Specialist*”.

Nga sa më sipër, konstatohet se, struktura dhe organika e miratuar për institucionin Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, janë organizuar duke u mbështetur në strukturën organizative hierarkike, të përcaktuar në dispozitat e ligjit nr. 9584, datë 17.07.2006, “*Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj*”, i ndryshuar. Konkretisht, në zbatim të nenit 10, pika 3, të ligjit të sipërcituar, në strukturën e institucionit të mbikëqyrur është parashikuar pozicioni i punës “*Sekretar i Përgjithshëm*”, si pozicioni më i lartë i raportimit në hierarkinë e shërbimit civil.

Klasifikimi i pozicioneve të shërbimit civil në kategorinë e lartë drejtuese, të mesme drejtuese, të ulët drejtuese dhe ekzekutive, është parashikuar në përputhje me nenin 19, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar si dhe të vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, i ndryshuar, ku në Kreun II, pika 5, ka përcaktuar klasat e zbatueshme për secilën kategori të shërbimit civil, si dhe emërtesën e pozicioneve të punës që i përkasin secilës klasë.

Po kështu, janë respektuar kërkesat e vendimit nr. 187, datë 08.03.2017, të Këshillit të Ministrave, “*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, Zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, Administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe Administratën e Prefektit*”, ku përcaktohen qartësisht kategorizimi i pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil si dhe kategoria e pagës për çdo pozicion pune, pjesë e shërbimit civil.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore, në strukturën aktuale të institucionit të mbikëqyrur, paraqitet si njësi e menaxhimit të burimeve njerëzore, bazuar në nenin 10, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe sipas përcaktimeve në nenin 4, shkronja “*f*”, të ligjit të sipërcituar, kjo njësi organizative përbën njësinë përgjegjëse për institucionin e pavarur, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Konkluzion:

Për të gjitha sa u analizua më sipër, në këtë rubrikë të raportit, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, arrin në konkluzionin se:

- Në përmbajtjen e strukturës organizative të institucionit të mbikëqyrrur, evidentohen në mënyrë të qartë, pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, si dhe pozicionet e punës ndaj të cilëve nuk zbatohet ligji për nëpunësin civil.
 - Gjatë analizës së strukturës në institucionin e mbikëqyrrur u konstatua se, për numrin e pozicioneve të analizuara më sipër është ruajtur një raport i drejtë midis pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, nga ato që kryejnë shërbime mbështetëse, apo që bëjnë pjesë tek njësitë publike direkte të shërbimit. Konstatohet se statusi i punësimit në institucion është i ndarë në tre nivele ku përfshihen : **a)** funksionarë politikë, **b)** nëpunës civilë e **c)** punonjës administrativë, si dhe përcaktohet klasifikimi i pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil sipas nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe kategoria e tyre e pagës.
 - Pozicioni i punës “Sekretar i Përgjithshëm”, është parashikuar si pozicioni më i lartë i raportimit në hierarkinë e shërbimit civil (në referencë të nenit 19, pika 4/a, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” dhe të vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”).
- 2. Statusi i punonjësve dhe nëpunësve aktuale, të gjendur në pozicione pune të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit (data 26.02.2014) dhe si janë respektuar kërkesat e nenit 67, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.**

Nisur nga fakti që institucioni Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më parë ka qenë i përfshirë dhe po kështu, aktualisht përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil, deklarimi i statusit të punësimit është bërë në respektim të kërkesave të përcaktuara në nenin 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Në këtë dispozitë dhe konkretisht në pikën 3, 4 dhe 6, të saj përcaktohet shprehimisht:

- pika 3, “Nëpunësit civilë ekzistues, punonjësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që janë rekrutuar sipas një procedure pranimi konkurruese, të ngjashme me atë të përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, apo që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë, për shkak të ligjit, nëpunës civilë”;
- pika 4, “Nëpunësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 3, të këtij neni, janë nëpunës civilë në periudhë prove dhe për ta zbatohen dispozitat e nenit 24 të këtij ligji. Periudha e provës fillon nga fillimi i shtrirjes së efekteve të këtij ligji”;
- pika 6, “Deklarimi i statusit të punësimit, sipas pikave 1, 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet nga njësia përgjegjëse pas verifikimit të procedurës së punësimit”.

Në mbështetje të pikës 8, të nenit 67 të ligjit, është miratuar vendimi nr. 116, datë 05.03.2014, i Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil, sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Dispozitat e sipër përmendura, përmbajnë kuadrin ligjor të zbatueshëm për deklarimin e statusit të punësimit pas verifikimit të procedurës së punësimit për të gjithë nëpunësit që mbanin pozicione pune të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Nga përpunimi dhe analiza e këtij dokumentacioni konstatohet se, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, funksiononte mbi bazën e strukturës të miratuar me vendimin nr. 16, datë 27.11.2012, të Kuvendit, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe numrit të punonjësve të Administratës në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve”. Referuar kësaj strukture, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kishte **30** pozicione pune pjesë e shërbimit civil, ku gjendja e pozicioneve të punës rezulton si më poshtë:

- ✓ **27** pozicione pune të plotësuar;
- ✓ **3** pozicione pune të lira. Bëhet fjalë për pozicionet “*Specialist në Drejtorinë e Komisioneve Zgjedhore, Trajnimit dhe Edukimit të Zgjedhësve*”; “*Inspektor në Drejtorinë e Komisioneve Zgjedhore, Trajnimit dhe Edukimit të Zgjedhësve*” dhe “*Përgjegjës i Sektorit të Marrëdhënive me Publikun*”

Në zbatim të akteve rregullative si më sipër, për të arritur në një konkluzion të saktë lidhur me ligjshmërinë e veprimeve të kryera nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, si njësi përgjegjëse për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nëse veprimet e saj janë kryer në përputhje me kërkesat e ligjit për deklarimin e statusit të punësimit, u verifikuan dhe u analizuan të gjitha materialet shkresore që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, si strukturën dhe organikën e institucionit që ishte në fuqi në datë 26.02.2014; listë prezencën dhe listë pagesën e punonjësve për muajin Shkurt 2014; dosjen individuale të çdo punonjësi të punësuar në pozicione të shërbimit civil (*aktet e emërimit, të dhënat lidhur me nivelin e diplomës dhe profilin e arsimit të lartë për çdo punonjës të punësuar në pozicione të shërbimit civil*), si dhe plotësimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil, sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Në përfundim të këtyre verifikimeve, rezulton se, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, në datën 23.04.2014, ka përfunduar procedurën e deklarimit të statusit të punësimit për punonjësit që ushtronin detyrën në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, situatë e cila paraqitet si më poshtë:

- **15 punonjës**, kanë qenë nëpunës civilë ekzistues, të rekrutuar sipas procedurave të konkurrimit përcaktuar në ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*” (*shfuqizuar*), për të cilët është deklaruar statusi i punësimit si “*Nëpunës civil*”, nga të cilët në 14 raste janë deklaruar me statusin e nëpunësit civil dhe në **(1)** një rast është deklaruar statusi i punësimit si “*Nëpunës civil në periudhë prove*” ;

- **3 punonjës**, kanë qenë punonjës ekzistues, të emëruar me akte të përkohshme emërimi, për një periudhë më pak se një vit, për të cilët është deklaruar statusi i punësimit si “Nëpunës civil në periudhë prove”.(Bëhet fjalë për punonjësit *****);
- **1 punonjës**, ka qenë punonjës ekzistues, emëruar nëpërmjet listës së pritjes pas ristrukturimit, si institut i parashikuar nga ligji i mëparshëm për shërbimin civil , për një periudhë më tepër se një vit, për të cilin është deklaruar statusi i punësimit si “Nëpunës civil”. (Bëhet fjalë për punonjësin *****);
- Për **8 punonjës** ka përfunduar marrëdhënia e punës me institucionin.

Nga analiza e materialeve të administruara gjatë procesit të mbikëqyrjes, rezulton se, punonjësit:

- ✓ ***** , ***** , ***** dhe ***** , janë liruar nga shërbimi civil për shkak të dorëheqjes;
- ✓ ***** dhe ***** , liruar nga detyra për shkak plotësimit të moshës së pensionit;
- ✓ ***** , është ndërprerë marrëdhënia e punësimit për shkak të pezullimit nga shërbimi civil (me kërkesë të saj),
- ✓ ***** , është ndërprerë marrëdhënia e punësimit për shkak të transferimit të përhershëm, në një institucion tjetër.

(Rastet do të trajtohen në mënyrë nominale në kapitullin nr. IX, të këtij projekti raporti).

Të dhënat e mbledhura për institucionin Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, janë materializuar në Tabelën nr. 1, që është pjesë e këtij materiali dhe pas analizës së tyre, situata paraqitet si më poshtë:

a. Nëpunës të cilët janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar në ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”.

Në institucionin e mbikëqyrur u konstatua se, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, **15** pozicione pune pjesë e shërbimit civil, janë plotësuar me nëpunës civil, të rekrutuar sipas procedurave të konkurrimit, të përcaktuar në dispozitat e ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, i shfuqizuar, të cilët përfitojnë statusin e nëpunësit civil për shkak të ligjit. Nga analiza e dokumentacionit të vënë në dispozicion vërehet se për 14 punonjës është deklaruar statusi nëpunës civil dhe për 1 punonjës është deklaruar statusi nëpunës civil në periudhë prove. Bëhet fjalë për punonjësit :

- ✓ ***** , ***** , ***** , ***** , ***** , ***** , ***** , ***** , ***** , ***** , ***** dhe ***** .

Në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit të ri për nëpunësin civil, këta punonjës kanë qenë nëpunës civilë të konfirmuar, në pozicionet e punës ku ligji i ka gjetur të emëruar.

Konstatohet se, procedura e deklarimit të statusit të punësimit “Nëpunës civil”, për këta punonjës, është kryer në zbatim të kërkesave të nenit 67, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

✓ *****

Në lidhje me këtë rast, u konstatua se, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, **1** pozicion pune pjesë e shërbimit civil, është plotësuar me nëpunës civil, i cili është rekrutuar sipas procedurave të konkurrimit, të përcaktuar në dispozitat e ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, i shfuqizuar, i cili në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit të ri, nuk kishte përmbushur periudhën e provës. Nga analiza e dokumentacionit të vënë në dispozicion, në lidhje me statusin e punësimit për këtë punonjës, vërehet se:

- Procedura e deklarimit të statusit të punësimit “Nëpunës civil në periudhë prove”, për punonjësen *****, është kryer në respektim të kërkesave të nenit 67, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Konkluzion:

Për të gjitha sa u analizua më sipër, në këtë rubrikë të raportit, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, arrin në konkluzionin se njësia përgjegjëse e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka zbatuar drejt ligjin në lidhje me deklarimin e statusit të punësimit si nëpunës civilë, pasi ata i përmbushin kushtet e parashikuara në nenin 67, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në aktet nënligjore që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të tij.

b. Punonjës të emëruar nga lista e pritjes, sipas ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil” (i shfuqizuar), para momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Nga analiza e materialeve të administruara gjatë procesit të mbikëqyrjes, rezulton se, në **1 rast**, në pozicion pune pjesë e shërbimit civil, është emëruar një punonjës i cili është sistemuar nga lista e pritjes e cila parashikohej nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, i ndryshuar (i shfuqizuar) dhe bëhet fjalë për punonjësin *****.

Duke u nisur nga analiza që i është bërë aktit të emërimit, ku përfshihet momenti i fillimit të marrëdhënieve të punës dhe atyre financiare, rezulton se, punonjësi në fjalë, **ka më shumë se një vit**, në pozicion pune pjesë e shërbimit civil, nga momenti që kanë filluar efektet juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Konstatohet se me Vendimin nr. 88, datë 27.12.2013, “Për lirim nga detyra dhe kalimin në listë pritje të një nëpunësi civil”, është liruar nga detyra “Drejtor prokurimi”, në institucionin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për shkak të ristrukturimit të institucionit dhe është emëruar me Vendimin nr. 2, datë 28.01.2014, në institucionin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në pozicionin “Inspektor”, në DKZTEZ, nga lista e pritjes, e cila ishte një institut i parashikuar në ligjin e mëparshëm për statusin e nëpunësit civil. Rezulton se me aktin nr. 554, datë 22.04.2014, ky punonjës është deklaruar “Nëpunës civil”, në pozicionin e mësipërm.

Aktualisht, nëpërmjet procedurës ngritjes në detyrë, ky punonjës vijon marrëdhënien e punës në pozicionin "Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve", në Drejtorinë e Shërbimeve dhe Logjistikës.

Konkluzion: Në këto rrethana, përfundimisht Komisioneri vlerëson se, në rastin konkret, njësia përgjegjëse ka zbatuar drejt ligjin në lidhje me deklarin e statusit të punësimit si "Nëpunës civil", pasi punonjësi i përmbush kushtet e parashikuara në nenin 67, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe në aktet nënligjore, që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të tij.

c. Punonjës, të cilët janë emëruar me akte të përkohshme emërimi, para momenti të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, për një periudhë më pak se një vit.

Nga analiza e materialeve të administruara në kuadër të procesit të mbikëqyrjes, rezulton se në 3 raste, në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në këtë institucion, janë emëruar punonjës me akte emërimi të përkohshëm, duke mos respektuar procedurat e konkurrimit, sikurse përcaktohej në nenin 13, të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil", i shfuqizuar.

Duke u nisur nga analiza që i është bërë akteve të emërimit, ku përfshihet momenti i fillimit të marrëdhënieve të punës dhe atyre financiare, rezulton se, këta punonjës, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civilë, kanë pasur më pak se një vit në pozicionet e punës përkatëse. Në këto raste, punonjësit janë deklaruar me statusin e nëpunësit civil në periudhë prove. Bëhet fjalë për punonjësit si më poshtë:

1. *****, emëruar me aktin nr. 3374 prot., datë 05.04.2013, në pozicionin "Drejtor", në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe me aktin nr. 564, datë 23.04.2014, është deklaruar "Nëpunës civil në periudhë prove", në pozicionin e mësipërm;
2. *****, emëruar me vendimin nr. 4, datë 31.01.2014, në pozicionin "Drejtor", në Drejtorinë e DKZTEZ dhe me aktin nr. 547, datë 22.04.2014, është deklaruar "Nëpunës civil në periudhë prove", në pozicionin e mësipërm;
3. *****, emëruar me aktin nr. 5905/3 prot., datë 05.07.2013, në pozicionin "Jurist", në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe me aktin nr. 562, datë 23.04.2014, është deklaruar "Nëpunës civil në periudhë prove", në pozicionin e mësipërm;

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, në tre rastet e analizuara më sipër, njësia përgjegjëse ka zbatuar drejt ligjin në lidhje me deklarin e statusit të punësimit si "Nëpunës civil në periudhë prove", pasi punonjësit i përmbushin kushtet e parashikuara në nenin 67, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe në aktet nënligjore, që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të tij.

II. Respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës sipas formatit të përcaktuar në ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, për të gjitha pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, u verifikuan përshkrimet e punës, për të vlerësuar nëse janë respektuar rregullat e

përcaktuara në vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar, akte që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.

Këto akte nënligjore, në përmbajtjen e tyre kanë përcaktuar rastet kur një institucion, pjesë e shërbimit civil, duhet të hartojë përshkrimet e punës, procedurat e hollësishme që duhet të ndiqen si dhe nëpunësit përgjegjës në këtë proces.

Më konkretisht, vendimi nr. 142, datë 12.03.2014, i Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar, në kreun IV *“Procedura dhe formati i përshkrimit të punës”* (pika 14), përcakton se:

“Përshkrimet e punës hartohen kur krijohen institucione të reja, kur ndryshon mënyra e organizimit të institucionit apo kur kanë ndodhur ndryshime ose miratime të legjislacionit specifik mbi bazën e të cilit funksionon institucioni”.

Përshkrimi i punës hartohet nga analisti i punës, në bashkëpunim me eprorin direkt të pozicionit respektiv të punës dhe në rastet kur analisti i punës mungon në strukturën e institucionit për të cilin ka lindur nevoja e hartimit të përshkrimeve të punës, ky proces realizohet nga drejtuesi i njësisë organizative për menaxhimin e burimeve njerëzore, në bashkëpunim me eprorin direkt të pozicionit respektiv të punës.

Nga përmbajtja e akteve të përshkrimit të punës të verifikuara në subjekt, konstatohet se në këto akte janë përfshirë elementet, sipas modelit standard të miratuar, si dhe të dhënat për pozicionin e punës, misioni, qëllimi i përgjithshëm i pozicionit të punës, detyrat kryesore, përgjegjësitë kryesore, zgjidhja e problemeve, vendimmarrja, mjedisi menaxherial, mbikëqyrja, stafi në varësi, kushtet e punës, si dhe është i nënshkruar nga organet kompetente.

Gjithashtu, konstatohet se organet hartuese të aktit për përshkrimin e punës, janë kujdesur që të plotësojnë me korrektësi të dhënat që kërkohen në ndarjen *“Kërkesa të posaçme”*, sipas vendit të punës sipas përcaktimeve të Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar. Në këtë ndarje janë përcaktuar kriteret e posaçme që duhet të zotërojë punonjësi, të tilla si: eksperiencia që duhet të ketë punonjësi për atë vend pune, kualifikimet dhe arsimiti i lartë që duhet të zotërojë nëpunësit, sipas rastit *“Bachelor”*, *“Master Profesional”* ose *“Master Shkencor”*.

Në lidhje me këtë aspekt të administrimit të shërbimit civil, nga ana e njësisë përgjegjëse dhe aktorëve të procesit të hartimit të formularit të përshkrimit të punës duhet të përdoret një manual standardesh, referuar praktikave më të mira, që në këtë rast është Udhëzimi nr. 1, datë 31.05.2017, i Departamentit të Administratës Publike *“Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”*, në lidhje me përshkrimin e klasifikimin e pozicioneve të punës në administratën shtetërore.

Konkluzion: Nga sa analizuam më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, procedura e ndjekur për hartimin dhe miratimin e përshkrimeve të punës në pozicionet e trajtuara si pjesë e shërbimit civil nga ana e njësisë përgjegjëse në institucionin e mbikëqyrur, është në përputhje me kërkesat e Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.

III. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil.

Administrimi i shërbimit civil për të gjithë institucionet e shërbimit civil bazohet në planin vjetor të pranimit në shërbimin civil, në zbatim të pikës 1 dhe 2, të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”.

Në zbatim të pikës 2, të ligjit të sipërcituar, institucionet e pavarura, jo më vonë se muaji Shkurt, miratojnë planet e veta të pranimeve vjetore, të cilat në zbatim të pikës 13, të aktit nënligjor të sipërcituar, duhet të publikohen në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare si dhe në stendat për njoftime publike të institucionit.

Në zbatim të pikës 2, të vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, njësia përgjegjëse në vendimin për planifikimin vjetor, duhet të përcaktojë a) numrin e vendeve vakante për të cilat duhet të shpallet konkurrimi për çdo kategori dhe klasë dhe b) grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm.

Ky vendim, i cili përcakton në mënyrë të hollësishme procedurën që duhet të ndiqet për hartimin e planit vjetor, në nenin 3 të tij, përcakton se në planifikimin vjetor të pranimit në shërbimin civil, duhet të mbahet parasysh mbushja e moshës së pensionit të nëpunësit civil, parashikimi i vendeve të reja në shërbimin civil dhe ecuria e krijimit të vendeve vakante në shërbimin civil për arsye të tjera të paparashikuara.

Në bazë të akteve të mbikëqyrura, u konstatua se, institucioni Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka përgatitur planin e nevojave për rekrutim për vitin 2018, i cili është miratuar me aktin nr. 165 prot., datë 07.02.2018, “Përcaktimi i planit vjetor për vitin 2018 të pranimeve në shërbimin civil”. Nga analiza e dokumentacionit të administruar, rezulton se, me shkresën nr. 192 prot., datë 13.02.2018 të Kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, “Mbi publikimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil”, ka bërë njoftimin për publikimin në portalin “Shërbimi Kombëtar i punësimit”. Nevojat e institucionit të mbikëqyrur për rekrutime për gjatë vitit 2018, rezultojnë në plotësimin e 8 pozicioneve të lira dhe konkretisht:

- ✓ 3 (tre) pozicione pune të kategorisë së ulët drejtuese;
- ✓ 2 (dy) pozicione pune të kategorisë ekzekutive;
- ✓ 3 (tre) pozicione pune, sipas ecurisë të krijimit të vendeve vakante në shërbimin civil për arsye të tjera, të parashikuara në pikën 3, të vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë mbikëqyrjes, konstatohet se, gjatë periudhës objekt mbikëqyrje, në institucionin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, janë përdorur drejt procedurat e përcaktuara në nenin 26, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Institucioni i mbikëqyrur ka përgatitur planin vjetor për vitin 2018, duke pasqyruar nevojat aktuale për rekrutim, duke mbajtur parasysh mbushjen e moshës së pensionit të nëpunësve civilë, të cilët aktualisht ushtrojnë detyrën në institucionin Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si dhe pozicionet vakante të krijuara si rezultat i miratimit të strukturës së re.

Gjithashtu, në zbatim të nenit 26, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në kuadër të planifikimit vjetor, njësia përgjegjëse ka miratuar numrin e pozicioneve të lira të nivelit të mesëm drejtues, të cilat do të plotësohen nëpërmjet procedurës së konkurrimit të hapur edhe për kandidatë nga jashtë shërbimit civil.

Konkluzion: Komisioneri çmon se, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, në cilësinë e njësisë përgjegjëse për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ka hartuar planin vjetor për pranimin në shërbimin civil për vitin 2018, sipas përcaktimeve të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimin në shërbimin civil”.

IV. Rastet e rekrutimeve, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar e në vijim.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, u verifikuan emërimet në pozicionet e shërbimit civil, nëpërmjet procedurave të konkurrimit të hapur, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, të kryera nga data 26.02.2014, që është data e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, deri në momentin e mbikëqyrjes.

Për periudhën objekt mbikëqyrje, evidentohen **20** emërimet të kryera sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Nga verifikimi i procedurës së ndjekur për plotësimin e vendeve të punës, që kanë rezultuar të lira, konstatohet se:

- ✓ **14** pozicione, janë plotësuar nëpërmjet pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, me konkurrim të hapur;
- ✓ **3** pozicione, janë plotësuar nëpërmjet ngritjes në detyrë, të cilat janë pozicione pune të kategorisë së nivelit të ulët drejtues
- ✓ **3** pozicione janë plotësuar nëpërmjet ngritjes në detyrë, pranim nga jashtë.

Në mënyrë të detajuar për secilën procedurë të ndjekur për plotësimin e vendeve të lira, konstatohet:

- ***Emërimet, nëpërmjet pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive.***

Në rastin e institucionit të mbikëqyrur, në zbatim të nenit 22, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, nëpërmjet pranimin në shërbimin civil përmes konkurrimit të

hapur, me akte emërimi të nxjerrë nga njësia përgjegjëse janë emëruar “Nëpunës civil në periudhë prove”, nëpunësit si më poshtë:

○ Për vitin kalendarik 2014:

- ***** , me aktin nr. 15 prot., datë 01.12.2014, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “Specialist, Inspektor”, në Drejtorinë e Komisioneve Zgjedhore, Trajnimit dhe Edukimit të Zgjedhësve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve;
- ***** , me aktin nr. 13 prot., datë 30.10.2014, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “Specialist” në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Jashtë, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

○ Për vitin kalendarik 2015:

- ***** , me aktin nr. 2 prot., datë 11.01.2016, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “Specialist IT”, në Drejtorinë e Teknologjisë dhe Informacionit, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

○ Për vitin kalendarik 2016:

- ***** , me aktin nr. 2 prot., datë 30.06.2016, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “Specialist, Inspektor”, në Drejtorinë e Komisioneve Zgjedhore, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

○ Për vitin kalendarik 2017:

- ***** , me aktin nr. 1731 prot., datë 21.03.2017, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “Specialist Protokoll Arkiv”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve;
- ***** , me aktin nr. 1640 prot., datë 20.03.2017, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “Specialist, Analistë Pune”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve;
- ***** , me aktin nr. 2387 prot., datë 27.04.2017, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “Jurist”, në Drejtorinë Juridike, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve;
- ***** , me aktin nr. 2386 prot., datë 27.04.2017, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “Jurist”, në Drejtorinë Juridike, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve;

- ******, me aktin nr. 11 prot., datë 04.01.2018, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “*Specialist Finance*”, në Drejtorinë e Financës në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve;
- ******, me aktin nr. 5813 prot., datë 30.10.2017, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “*Specialist Trajnimi*”, në Sektorin e Trajnimeve të Komisioneve Zgjedhore, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve;
- ******, me aktin nr. 4402/2 prot., datë 24.06.2017, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “*Specialist Jurist*”, në Drejtorinë Juridike, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve;
- ******, me aktin nr. 4401/2 prot., datë 24.06.2017, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “*Specialist Jurist*”, në Drejtorinë Juridike, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve;
- ******, me aktin nr. 231 prot., datë 25.01.2017, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “*Specialist, Redaktor*”, në Sektorin e Edukimit të Zgjedhësve, në Drejtorinë e Komisioneve Zgjedhore, Trajnimit dhe Edukimit të Zgjedhësve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve;
- ******, me aktin nr. 2529 prot., datë 03.05.2017, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “*Specialist IT*”, në Drejtorinë e Teknologjisë dhe Informacionit, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
- Për vitin kalendarik 2018:
 - ******, me aktin nr. 594 prot., datë 12.04.2018, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “*Specialist*”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore.
 - ******, me aktin nr. 613 prot., datë 16.04.2018, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin për kontrollin e financimit e partive politike, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

- ***Emërime, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele***

Në rastin e institucionit të mbikëqyrur, në zbatim të nenit 25, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, nëpërmjet ngritjes në detyrë, me akte emërimi të nxjerrë nga njësia përgjegjëse janë emëruar nëpunësit si më poshtë:

- ******, me aktin nr. 712 prot., datë 25.01.2018, është emëruar nëpunës civil në pozicionin “*Përgjegjës i Sektori*”, në Drejtorinë Juridike.

- **Emërime, nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë**

Në rastin e institucionit të mbikëqyrur, në zbatim të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, nëpërmjet ngritjes në detyrë, me akte emërimi të nxjerrë nga njëzia përgjegjëse janë emëruar nëpunësit si më poshtë:

- Për vitin kalendarik 2014:

- ******, me aktin nr. 14prot., datë 31.10.2014, është emëruar nëpunës civil në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve” në Drejtorinë e Shërbimeve dhe Logjistikës.

- Për vitin kalendarik 2017:

- ******, me vendimin nr. 192 prot., datë 31.03.2017, është emëruar nëpunës civil në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Edukimit të Zgjedhësve” në Drejtorinë e Komisioneve Zgjedhore, Trajnimit dhe Edukimit të Zgjedhjeve.

Rezulton se, nëpunësi në fjalë me kërkesën nr. 5561/2, datë 25.09.2017, ka kërkuar transferim të përhershëm për arsye shëndetësore nga pozicioni i punës “Përgjegjës i Sektorit të Edukimit të Zgjedhësve” në Drejtorinë e Komisioneve Zgjedhore, Trajnimit dhe Edukimit të Zgjedhjeve, në pozicionin e mëparshëm të punës “Specialist Jurist”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, i cili ishte pozicion i lirë pune.

Me vendim nr. 2, datë 17.10.2017, “Për transferimin e përhershëm të z. Blendi Kodra nga pozicioni i punës Përgjegjës i Sektorit të Edukimit të Zgjedhësve në DKZETEZ, në pozicionin Jurist Prokurimeve”, është aplikuar instituti i transferimit të përhershëm.

- Për vitin kalendarik 2018:

- ******, me aktin nr. 601 prot., datë 16.01.2018 është emëruar nëpunës civil në pozicionin “Përgjegjës Sektori”, në Drejtorinë e Shërbimeve dhe Logjistikës.

Në lidhje me procedurat e mësipërme të konkurrimit, nëpërmjet ngritjes në detyrë, Komisioneri vëren se, nga ana e njësisë përgjegjëse janë respektuar të gjitha etapat e përcaktuara në dispozitat e vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”.

- **Emërime nëpërmjet procedurës pranimit nga jashtë shërbimit civil**

Në kuptim të nenit 26, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, rezulton se Këshilli i Ministrave, për institucionet e administratës shtetërore dhe organi kompetent, për institucionet e pavarura, mund të vendosë që procedura e plotësimit të vendeve të lira për kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë, të cilët plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin e punës. Sipas kësaj dispozite, plotësimi i vendeve të lira në këtë kategori nuk mund të kalojë 20% të numrit total të vendeve në çdo vit kalendarik.

Ndërsa, pranimi në kategorinë e nëpunësve civilë të lartë drejtues në institucionet e pavarura, përjashtimisht titullari/organi vendimmarrës i institucionit, mund të vendosë që procedura e pranimit të jetë e hapur edhe për kandidatët e tjerë, jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat specifike për pranimin në këtë kategori, por në asnjë rast ky numër nuk mund të jetë më shumë se 20 % të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kategorisë së lartë drejtuese për atë institucion.

Nga analiza e dokumentacionit të administruar, rezulton se, për **3 raste** është aplikuar procedura e konkurrimit të hapur për konkurrentë nga jashtë shërbimit civil, në procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë.

Në institucionin e mbikëqyrur është lejuar pjesëmarrja e kandidatëve nga jashtë shërbimit civil për gjatë çdo viti kalendarik si më poshtë vijon:

- për gjatë vitit 2016 është rekrutuar një nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues;
- për gjatë vitit 2017 është rekrutuar një nëpunës i nivelit të lartë drejtues dhe
- për gjatë vitit 2018 është rekrutuar një nëpunës i nivelit të ulët drejtues.

Bëhet fjalë për nëpunësit:

1. ******, me aktin nr. 3 prot., datë 21.09.2016, është emëruar nëpunës civil në pozicionin “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Shërbimit dhe Logjistikës, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, realizohen nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe në rast të mosplotësimit të tyre vijohet me procedurën e ngritjes në detyrë. Por përjashtimisht, organi kompetent, mund të vendosë që procedura e plotësimit të vendeve të lira për këto kategori të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin/vendet e lira, por në çdo rast, siç u theksua dhe më lartë, nuk mund të kalojë 20 % të numrit total të vendeve në çdo vit kalendarik.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se, në zbatim të nenit 26, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar ku përjashtimisht, Këshilli i Ministrave, për institucionet e administratës shtetërore dhe organi kompetent për institucionet e pavarura mund të vendosë që procedura e plotësimit të vendeve të lira për kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin/vendet e lira drejtuese, si dhe Kreut III, pika 43, të vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”, rezulton se me vendimin nr. 1, datë 08.08.2016, të Kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është vendosur që në procedurën e konkurrimit pranim nga jashtë shërbimit civil për pozicionin “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Shërbimit dhe Logjistikës, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, të lejohet pjesëmarrja edhe e kandidatëve nga jashtë shërbimit civil.

Në përfundim të procedurës së konkurrimit, rezulton se kandidati ******, është shpallur kandidat fitues dhe me aktin nr. 613 prot., datë 16.04.2018, të njësisë përgjegjëse është emëruar në pozicionin “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Shërbimit dhe Logjistikës, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

2. ******, me aktin nr. 60 prot., datë 15.03.2017, është emëruar në pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm”, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Konstatohet se në një rast është vendosur që në procedurën e konkurrimit pranim nga jashtë shërbimit civil, për nëpunës civil të nivelit të lartë drejtues, duke mos tejkaluar 15 % të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kategorisë së lartë drejtuese për atë institucion.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar gjatë procesit të mbikëqyrjes rezulton se, në zbatim të nenit 32, pika 1 dhe 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe të vendimit nr. 118, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e emërimit rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, i ndryshuar, me vendimin nr. 1, datë 05.01.2017, të Kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është lejuar që në procedurën e konkurrimit pranim nga jashtë shërbimit civil, për pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm”, të marrin pjesë kandidatë nga jashtë shërbimit civil.

Në përfundim të procedurës së konkurrimit, rezulton se kandidati ******, është shpallur kandidat i suksesshëm dhe me aktin nr. 60 prot., datë 15.03.2017, të njësisë përgjegjëse është emëruar në pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm”, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

3. ******, me aktin nr. 613 prot., datë 16.04.2018, është emëruar nëpunës civil në pozicionin “Përgjegjës”, në Sektorin e Edukimit të Zgjedhësve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se, në zbatim të nenit 26, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe Kreut III, pika 43, të vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, me vendimin nr. 1, datë 28.02.2018, të Kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është vendosur që në procedurën e konkurrimit, pranim nga jashtë shërbimit civil për pozicionin “Përgjegjës”, në Sektorin e Edukimeve të Zgjedhësve, të lejohet pjesëmarrja e kandidatëve nga jashtë shërbimit civil.

Në përfundim të procedurës së konkurrimit, rezulton se kandidatja **Anduela Ndreu**, është shpallur candidate e suksesshme dhe me aktin nr. 613 prot., datë 16.04.2018, të njësisë përgjegjëse është emëruar në pozicionin “Përgjegjës”, në Sektorin e Edukimit të Zgjedhësve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Në përfundim të analizës së dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me institutin e pranimit në shërbimin civil, për emërimet, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive rezultoi se, për vitin kalendarik 2014, procedura materializohet me aktet:

1. Vendimi nr. 15, datë 17.11.2014, “Për përbërjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimit”, nëpërmjet të cilit është ngritur Komiteti i Përhershëm i Pranimit (KPP), për procedurën e pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, për pozicione pune “Specialist në Drejtorinë e Komisioneve Zgjedhore, Trajnimit dhe Edukimit të Zgjedhësve”;
- ✓ Vendimi nr. 1794, datë 25.11.2014, i KPP, për përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm.
- ✓ Akti nr. 1800 prot., datë 26.11.2014, për publikimin e kandidatit fitues *****.

2. Vendimi nr. 10, datë 03.09.2014, “Për përbërjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimit”, nëpërmjet të cilit është ngritur Komiteti i Përhershëm i Pranimit (KPP), për procedurën e pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, për pozicione pune “*Specialist në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Jashtë*”;
- ✓ Vendimi nr. 1794, datë 25.11.2014, i KPP, për përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm.
- ✓ Akti nr. 1404 prot., datë 23.10.2014, për publikimin e kandidatit fitues, *****.

Në përmbajtjen e këtyre akteve janë përcaktuar edhe ekspertët e jashtëm të konkurrimit, si kërkesë ligjore e një procesi të rregullt.

Për gjatë vitit kalendarik 2014, është zhvilluar procedura e ngritjes në detyrë ku konstatohet se me vendimin, nr. 12, datë 14.10.2014, është ngritur Komiteti i Pranimit për Ngritje në Detyrë (KPND) për procedurat e ngritjes në detyrë, për pozicionin e punës “*Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve në Drejtorinë e Shërbimeve dhe Logjistikës*” dhe me shkresën nr. 1404 prot., datë 23.10.2014, është publikuar kandidati fitues, *****.

- Për gjatë vitit kalendarik 2015, procedura e rekrutimit materializohet me aktet:

1. Vendimi nr. 1, datë 05.01.2016, “Për përbërjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimit”, nëpërmjet të cilit është ngritur Komiteti i Përhershëm i Pranimit (KPP), për procedurën e pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, për pozicionin e punës “*Specialist IT, në Drejtorinë e Teknologjisë dhe Informacionit*”;
- ✓ Vendimi nr. 6, datë 07.01.2016, i KPP, për përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm. Shkresa nr. 17 prot., datë 08.01.2016, drejtuar SHKP, për publikimin e kandidatit fitues *****;
2. Vendimi nr. 16, datë 16.09.2015, “Për përbërjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimit”, nëpërmjet të cilit është ngritur Komiteti i Përhershëm i Pranimit (KPP), për procedurën e pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, për pozicionin e punës “*Specialist (Inspektor), në Drejtorinë e Komisioneve Zgjedhore, Trajnimit dhe Edukimit të Zgjedhësve*”;
- ✓ Vendimi nr. 7638 prot., datë 18.09.2015, i KPP, për përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm;
- ✓ Akti nr. 7641 prot., datë 21.09.2015, drejtuar SHKP, për publikimin e fituesit *****;

Për gjatë vitit kalendarik 2016, procedura materializohet me aktet:

1. Vendim nr. 1, datë 08.08.2016, për plotësimin e pozicionin të lirë të punës “*Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve dhe Logjistikës*” me procedurë të hapur edhe për kandidatë jashtë shërbimit civil;
- ✓ Vendimi 16, datë 16.09.2015, “Për përbërjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimit”, nëpërmjet të cilit është ngritur Komiteti i Përhershëm i Pranimit (KPP),

- ✓ Shkresa nr. 3125 prot., datë 22.08.2016, drejtuar SHKP për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele pa kandidatë;
 - ✓ Shkresa nr. 3196 prot., datë 29.08.2016, për publikimin e kandidatëve të kualifikuar për fazën e ngritjes në detyrë dhe pranimit nga jashtë, ***** dhe *****;
 - ✓ Vendimi nr. 3270/1, datë 15.09.2016, i KND, për shpalljen e kandidatit të suksesshëm, *****;
 - ✓ Njoftimi nr. 3302 prot., datë 20.09.2016, drejtuar SHKP për publikimin e kandidatit fitues, *****;
2. Vendimi nr. 1, datë 05.01.2016, “Për përbërjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimit”, nëpërmjet të cilit është ngritur Komiteti i Përhershëm i Pranimit (KPP), për procedurën e pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, për pozicionin e punës “*Specialist (Inspektor) në Drejtorinë e Komisioneve Zgjedhore*”;
 - ✓ Vendimi nr. 6, datë 07.01.2016, i KPP, për përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm.
 - ✓ Akti nr. 17 prot., datë 08.01.2016, drejtuar SHKP, për publikimin e kandidatit fitues *****;
3. Vendimi nr. 2704 prot., datë 20.06.2016, “Për përbërjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimit”, nëpërmjet të cilit është ngritur Komiteti i Përhershëm i Pranimit (KPP), për procedurën e pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, për pozicionin e punës “*Specialist (Inspektor) në Drejtorinë e Komisioneve Zgjedhore*”;
 4. Njoftimi nr. 2526 prot., datë 26.05.2016, për përfundimin e lëvizjes paralele pa kandidatë;
 5. Shkresa nr. 2594 prot., datë 08.06.2016, për publikimin e listës së kandidatëve të kualifikuar për procedurën e pranimit në shërbimin civil, e kandidatit *****;
 6. Shkresa nr. 2175/1, datë 21.06.2016, e KPP, për përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm *****;
 7. Shkresa nr. 2782 prot., datë 22.06.2016, drejtuar SHKP, për publikimin e shpalljes së fituesit.
 - Për gjatë vitit kalendarik 2017, procedura materializohet me aktet:
 - Vendimi nr. 1, datë 05.01.2017, për miratimin e zhvillimit të procedurës së hapur, marrjes nga jashtë shërbimit civil;
 - 1. Vendimi nr. 1391/1, datë 06.03.2017, “Për përbërjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimit”, nëpërmjet të cilit është ngritur Komiteti i Përhershëm i Pranimit (KPP), për procedurën e hapur, marrje nga jashtë shërbimit civil, për pozicionin e punës “*Sekretar i Përgjithshëm*”;
 - ✓ Njoftimi nr. 1441 prot. 10.03.2017, për kandidatin e suksesshëm (fitues), *****;
 - ✓ Njoftimi nr. 1470 prot., datë 13.03.2017, për shpalljen e fituesit drejtuar Shërbimit Kombëtar të Punësimit.
 2. Vendimi nr. 5, datë 16.03.2017, “Për përbërjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimit”, nëpërmjet të cilit është ngritur Komiteti i Përhershëm i Pranimit (KPP), për procedurën e pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, për pozicionin e punës “*Specialist Protokoll - Arkiv*”;

- ✓ Njoftimi nr. 1629/1 prot. datë 20.03.2017, për kandidatin e suksesshëm (fitues),
*****.
- 3. Vendimi nr. 4, datë 15.03.2017, “Për përbërjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimit”, nëpërmjet të cilit është ngritur Komiteti i Përhershëm i Pranimit (KPP), për procedurën e pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, për pozicionin e punës “*Specialist për marrëdhëniet e punës*”;
- ✓ Njoftimi nr. 1650 prot., datë 20.03.2017, drejtuar Shërbimit Kombëtar të Punësimit për shpalljen e kandidatit fitues *****;
- 4. Vendimi nr. 6, datë 10.03.2017, “Për përbërjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimit”, nëpërmjet të cilit është ngritur Komiteti i Përhershëm i Pranimit (KPP), për procedurën e pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, për pozicionin e punës “*Specialist Jurist*”;
- ✓ Shkresa nr. 1839 prot., datë 27.03.2017, njoftimi për kandidatët e kualifikuar për fazën e pranimit në shërbimin civil;
- ✓ Vendimi nr. 2178 prot., datë 14.04.2017, i KPP, për shpalljen e kandidatit fitues *****.
- 5. Vendimi nr. 6045 prot., datë 05.12.2017, “Për përbërjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimit”, nëpërmjet të cilit është ngritur Komiteti i Përhershëm i Pranimit (KPP), për procedurën e pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, për pozicionin e punës “*Specialist Finance*”;
- ✓ Vendimi nr. 6079 , datë 11.12.2017, I KPP, për shpalljen e kandidatit fitues;
- ✓ Njoftimi nr. 6083 prot., datë 11.12.2017, për shpalljen e fituesit, drejtuar Shërbimit Kombëtar të Punësimit të *****.
- 6. Vendimi nr. 5499 prot., datë 11.09.2017, “Për përbërjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimit”, nëpërmjet të cilit është ngritur Komiteti i Përhershëm i Pranimit (KPP), për procedurën e pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, për pozicionin e punës “*Specialist Trajnimi në DKZTEZ*”;
- ✓ Shkresa nr. 5768 prot., datë 24.10.2017, drejtuar Shërbimit Kombëtar të Punësimit, për publikimin e fituesit të konkursit, kandidates ***** , bashkëlidhur njoftimi i njësisë përgjegjëse, i datës 23.10.2017, për shpalljen e fituesit;
- 7. Vendimi nr. 3829 prot., datë 11.06.2017, “Për përbërjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimit”, nëpërmjet të cilit është ngritur Komiteti i Përhershëm i Pranimit (KPP), për procedurën e pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, për pozicionin e punës “*Specialist Jurist*”;
- ✓ Vendim i KPP nr. 3990, datë 13.06.2017 për shpalljen e 3 kandidatëve fitues, ***** , ***** dhe *****;
- ✓ Shkresa nr. 4347 prot., datë 23.06.2017, drejtuar Shërbimit Kombëtar të Punësimit, për publikimin e fituesve të konkursit, ***** , ***** dhe ***** , bashkëlidhur njoftimi i njësisë përgjegjëse, i datës 23.06.2017, për shpalljen e fituesit;

8. Vendimi nr. 3940 prot., datë 10.05.2017, “Për përbërjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimi”, nëpërmjet të cilit është ngritur Komiteti i Përhershëm i Pranimi (KPP), për procedurën e pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive për pozicionin e punës “Specialist për edukimin e zgjedhësve”;
 - ✓ Njoftimi nr. 3441 prot., datë 30.05.2017, drejtuar SHKP, për vazhdimin e procedurës së pranimit në shërbimin civil, bashkëngjitur njoftimi i njësisë përgjegjëse, datë 31.05.2017, për njoftimin e kualifikimit të kandidatës *****.
 - ✓ Vendim nr. 4120 prot., datë 16.06.2017, i KPP, për përzgjedhjen e kandidatit fitues
 - ✓ Shkresa nr. 4346 prot., datë 23.06.2017, për njoftimin e kandidatit fitues, bashkëngjitur njoftimi i njësisë përgjegjëse për rezultatin e vlerësimit përfundimtar të kandidatës
9. Vendimi nr. 2336 prot., datë 21.04.2017, “Për përbërjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimi”, nëpërmjet të cilit është ngritur Komiteti i Përhershëm i Pranimi (KPP), për procedurën e pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, për pozicione pune “Specialist në Drejtorinë e Teknologjisë dhe Informacionit”;
 - ✓ Njoftimi nr. 1947 prot., datë 30.03.2017, për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele pa kandidatë, bashkëngjitur njoftimi i njësisë përgjegjëse i datës 30.03.2017;
 - ✓ Shkresa nr. 2099 prot., datë 10.04.2017, për publikimin e kandidatit ***** , të kualifikuar për procedurën e pranimit në shërbimin civil, bashkëngjitur njoftimi i njësisë përgjegjëse;
 - ✓ Vendimi nr. 2398/1 prot., datë 27.04.2017, i KPP, për përzgjedhjen e kandidatit fitues;
 - ✓ Njoftimi nr. 2494 prot., datë 03.05.2017, drejtuar SHKP, për publikimin e kandidatit fitues, bashkëlidhur njoftimi i njësisë përgjegjëse.

Për gjatë vitit kalendarik 2018, procedura materializohet me aktet:

1. Për gjatë vitit kalendarik 2014, është zhvilluar procedura e lëvizjes paralele ku konstatohet se me vendimin, nr. 40, datë 09.01.2018, për ngritjen e Komisionit të Brendshëm për lëvizjen paralele, për pozicionin e punës “Përgjegjës Sektori në Drejtorinë Juridike” dhe me akti nr. 76 prot., datë 17.01.2018, i Komisionit, për njoftimin e fituesit;
 - ✓ Akti nr. 95 prot., datë 23.01.2018, drejtuar SHKP për publikimin e fituesit *****.
2. Vendimi nr. 448 prot., datë 28.03.2018, “Për përbërjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimi”, nëpërmjet të cilit është ngritur Komiteti i Përhershëm i Pranimi (KPP), për procedurën e pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, për pozicione pune “Specialist i Burimeve Njerëzore”;
 - ✓ Vendim nr. 448/2 prot., datë 30.03.2015, i Komitetit të Përhershëm të Pranimi, për përzgjedhjen e kandidati fitues, *****;
 - ✓ Akti nr. 554 prot., datë 05.04.2018, drejtuar SHKP për publikimin e fituesit;
3. Për gjatë vitit kalendarik 2018, është zhvilluar procedura e ngritjes në detyrë ku konstatohet se me vendimin, nr. 308, datë 06.03.2018, është ngritur Komiteti i Pranimi për Ngritje në Detyrë (KPND) për procedurat e ngritjes në detyrë, për pozicionin e punës

“Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Shërbimeve dhe Logjistikës” dhe me Vendim nr. 455/2 prot., datë 03.04.2018, i KPP, për përzgjedhjen e kandidatit fitues *****.

4. Vendimi nr. 448 prot., datë 28.03.2018, “Për përbërjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimit”, nëpërmjet të cilit është ngritur Komiteti i Përhershëm i Pranimit (KPP), për procedurën e pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, për pozicionin e puns “Specialist në Sektorin për kontrollin e financimin e partive politike”;
 - ✓ Vendimi nr. 448/2 prot., datë 30.03.2015, i Komitetit të Përhershëm të Pranimit, për përzgjedhjen e kandidati fitues, *****;
 - ✓ Akti nr. 584 prot. Datë 11.04.2018, drejtuar SHKP, për publikimin e fituesit
5. Vendimi nr. 573 prot., datë 10.04.2018, “Për përbërjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimit”, nëpërmjet të cilit është ngritur Komiteti i Përhershëm i Pranimit (KPP), nëpërmjet procedurës së hapur, ngritjes në detyrë, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, për pozicionin e punës “Përgjegjës Sektori i Edukimit të Zgjedhësve në Drejtorinë e Komisioneve Zgjedhore,” me procedurë të hapur (20% pranim nga jashtë)
 - ✓ Akti nr. 440 prot., datë 27.03.2018, drejtuar SHKP, për publikimin e listës së kandidatëve që do të marrin pjesë në konkurrim, *****; bashkangjitur njoftimi i njësisë përgjegjëse
 - ✓ Vendimi nr. 573/2 prot., datë 12.04.2018, i KPP, për përzgjedhjen e kandidatit fitues.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë mbikëqyrjes në institucionin e KQZ-së vërtetohet se janë publikuar pozicionet e lira në Portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe stendën e institucionit, në përputhje me ligjin, me aktet që administrohen në dosjen e rekrutimit si dhe në dosjen e mbikëqyrjes.

Pozicionet më sipër, fillimisht ju janë ofruar nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele. Në përfundim të afatit të përcaktuar, janë realizuar njoftimet përkatëse për procedurën e lëvizjes paralele dhe më pas për procedurën e pranimit në shërbimin civil.

Njësia Përgjegjëse e KQZ, pasi ka kryer procesin e verifikimit paraprak të kandidatëve të cilët plotësonin kërkesat e përgjithshme dhe ato të veçanta të përcaktuar në shpalljen për konkurrim, ka dërguar për shpallje në Portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, listën me aplikantët e kualifikuar për të vazhduar në fazën e konkurimit dhe datat e testimit, për pozicionet e publikuara. Më pas është vazhduar me procedurën e konkurimit.

Nga sa më sipër rezulton se proceset e konkurimit janë kryer në përputhje të plotë me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, procedurat e konkurimit, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, janë zhvilluar në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij.

- V. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës, detyrimet e nëpunësit dhe procedura e vendimmarrjes në përfundim të kësaj periudhe.

Nëpunësit civil, që emërohen për herë të parë në shërbimin civil i nënshtrohen një periudhe prove. Afati i periudhës së provës si dhe detyrat që duhet të përmbushë nëpunësi civil dhe institucioni përgjatë kësaj periudhe dhe në përfundim të saj, janë të përcaktuara në nenin 24, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; në Kreun V, të vendimit nr. 143, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”, (për të gjitha ato procedura që kanë filluar gjatë kohës që ka qenë në fuqi kjo VKM); si dhe në Kreun VI, të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”.

Ndërsa për nëpunësit dhe punonjësit ekzistues, (nëpunësit dhe punonjësit që fillimi i efekteve të ligjit i gjeti në funksione të shërbimit civil) dhe që kishin një periudhë punësimi më të vogël se 1 (një) vit, në pikën 4, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, është përcaktuar se për ta zbatohet neni 24, i këtij ligji dhe se periudha e provës fillon nga fillimi i efekteve të ligjit.

Në mbështetje të këtyre dispozitave ligjore, nëpunësi në periudhë prove është i detyruar të ndjekë programin e detyrueshëm të trajnimit për periudhën e provës pranë ASPA-s dhe udhëzimet e nëpunësit më të vjetër civil, nën kujdesin e të cilit ai është vendosur.

Eprori direkt i nëpunësit në periudhë prove, duhet të caktojë nëpunësin më të vjetër nën kujdesin e të cilit do të vendoset nëpunësi civil në periudhë prove, të bëjë vlerësimin e rezultateve individuale në punë për periudhën e provës dhe të nxjerrë vendimin për përfundimin e periudhës së provës.

Në zbatim të planit të mbikëqyrjes, u verifikuan tërësinë e veprimeve të kryera për konfirmimin e nëpunësve civile, të cilët i janë nënshtuar periudhës së provës dhe që aktualisht vazhdojnë marrëdhënien e punësimit me institucionin.

Nga verifikimet e kryera në institucion, rezulton se përgjatë vitit 2015, kanë përfunduar periudhën e provës 5 nëpunës, të cilët janë emëruar nëpërmjet procedurës së konkurrimit, pranin në shërbimin civil. Bëhet fjalë për nëpunësit:

a. Rastet në periudhë prove për shkak të fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil:

- ***** , emëruar me aktin nr. 5 prot., datë 31.01.2014, nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “Drejtor”, në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Jashtë. Me vendimin nr. 2, datë 30.01.2015, është konfirmuar nëpunës civil, në pozicionin e mësipërm;
- ***** , emëruar me aktin nr. 564 prot., datë 23.04.2014, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “Drejtor”, në Drejtorinë e Burimeve Në përfundim të periudhës së provës është konfirmuar nëpunës civil me vendimin nr. 4, datë 26.02.2015.
- ***** , emëruar me aktin nr. 562 prot., datë 23.04.2014, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “Jurist”, në Drejtorinë Juridike. Në përfundim të periudhës së provës është konfirmuar nëpunës civil me vendimin nr. 1, datë 26.02.2015.

- ***** , emëruar me aktin nr. 547 prot., datë 22.04.2014, emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “Drejtor”, në DETKZ. Në përfundim të periudhës së provës është konfirmuar nëpunës civil me vendimin nr. 3, datë 30.01.2015.

b. Raste në periudhë prove për shkak të konkurrencimit.

- ***** , emëruar me aktin nr. 13 prot., datë 30.10.2014, nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “Specialist”, në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Jashtë. Në përfundim të periudhës së provës është konfirmuar nëpunës civil me vendimin nr. 18, datë 03.11.2015;
- ***** , me aktin nr. 15 prot., datë 01.12.2014, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “Specialist, Inspektor”, në Drejtorinë e Komisioneve Zgjedhore, Trajnimit dhe Edukimit të Zgjedhësve, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, konfirmuar me Vendim nr. 7986, datë 01.12.2015, në pozicionin aktual të punës;
- ***** , me aktin nr. 2 prot., datë 11.01.2016, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “Specialist IT”, në Drejtorinë e Teknologjisë dhe Informacionit, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve konfirmuar me Vendimin nr. 1 datë 12.01.2017, në pozicionin aktual të punës;
- ***** , me aktin nr. 2 prot., datë 30.06.2016, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin “Specialist, Inspektor”, në Drejtorinë e Komisioneve Zgjedhore, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve konfirmuar me Vendimin nr. 5028, datë 02.07.2017, në pozicionin aktual të punës;

Nga verifikimi i akteve që materializojnë procedurën e zbatuar për konfirmimin pas përfundimit të periudhës së provës rezulton se për (5) nëpunësit ***** , ***** , ***** , ***** dhe ***** , janë respektuar detyrimet e përcaktuara në nenin 24, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Ndërsa në rastin e punonjësës ***** , vendimi i konfirmimit në përfundim të periudhës së provës ka dalë në kundërshtim me përcaktimet e nenit 24, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Rezulton se gjatë periudhës së provës, kjo nëpunëse nuk ka kryer ciklin e detyrueshëm pranë ASPA-s, si detyrim i përcaktuar në nenin 24, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Në këto rrethana, njësia përgjegjëse dhe eprori direkt ka interpretuar gabim ligjin, pasi në rastin e punonjësve që e fituan statusin e nëpunësit civil për arsye se i gjeti në punë ligji për nëpunësin civil në një pozicion të shërbimit civil, për një periudhë më të vogël se një vit, pavarësisht nga kategorizimi i pozicionit të punës, janë përfshirë në periudhë prove. Në këto rrethana, pavarësisht faktit se pozicioni i punës është në nivelin e mesëm drejtues, nëpunësja duhet të kryente trajnimin e detyrueshëm pranë shkollës së Administratës Publike.

Për këtë arsye, njësia përgjegjëse, në bashkëpunim me Shkollën e Administratës Publike duhet të krijojnë kushtet që punonjësja ***** , të ndjekë trajnimin e detyrueshëm për nëpunësit në periudhë prove.

Në lidhje me rekrutimet e kryera në periudhën 2017-2018, për punonjësit e emëruar në pozicionet e kategorisë ekzekutive dhe të rekrutuar sipas procedurës së konkurrimit, në momentin e mbikëqyrjes nuk ka përfunduar afati i periudhës së provës.

Nga verifikimi i dokumentacionit për këto raste, rezulton se, nëpunësit civilë në periudhë prove, *****, ***** dhe *****, kanë ndjekur trajnimin e detyrueshëm gjatë muajit Mars 2018 pranë ASPA-s dhe në fund të trajnimit i janë nënshtruar testimit e janë pajisur me certifikatat përkatëse që e vërtetojnë këtë fakt.

Bazuar në pikën 2, të Kreut IV, të vendimit nr. 138, datë 12.3.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e organizimit e të funksionimit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe trajnimin e nëpunësve civilë”, i ndryshuar, trajnimi për periudhën e provës pranë ASPA-s, konsiderohet i ndjekur me sukses, nëse nëpunësi merr të paktën 50 % të pikëve në testim.

Nga verifikimi i vërtetimeve (*certifikatave*) të lëshuara nga ASPA rezulton se, në testimet përfundimtare të nëpunësve të lartë përmendur, janë vlerësuar me mbi 50 % të pikëve.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton gjithashtu se, punonjësit e mësipërm, deri në momentin e mbikëqyrjes nuk janë konfirmuar si nëpunës civil, pasi nuk i ka përfunduar afati i periudhës së provës.

Ndërsa në 7 raste, nëpunësit të cilët deri në momentin e mbikëqyrjes vazhdojnë periudhën e provës, *****, *****, *****, *****, *****, *****, ***** dhe *****, ende nuk i janë nënshtruar ciklit të detyrueshëm të trajnimit pranë ASPA-s.

Njësia e burimeve njerëzore të institucionit të Komisioni Qendror të Zgjedhjeve, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, në lidhje me përmbushjen e kërkesave ligjore të periudhës së provës dhe përmbylljes së saj për punonjësit që nuk e kanë përfunduar periudhën e provës duhet të mbajë në vëmendje këto aspekte:

- Të krijojë mundësinë e ndjekjes së trajnimit të detyrueshëm dhe më tej të administrohet rezultati i testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA).
- Në lidhje me këta punonjës, në kushtet kur është kryer cikli i detyrueshëm i trajnimit pranë ASPA-s dhe në fund të trajnimit është zhvilluar testimi, sipas pikës 2, të Kreut IV, të vendimit nr. 138, datë 13.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e organizimit e të funksionimit të shkollës shqiptare të administratës publike dhe trajnimin e nëpunësve civil”, i ndryshuar trajnimi për periudhën e provës pranë ASPA-s konsiderohet i ndjekur me sukses nëse nëpunësi merr të paktën 50 % të pikëve në testim.
- Eprori direkt i nëpunësit në periudhë prove, duhet të caktojë nëpunësin më të vjetër, nën kujdesin e të cilit do të vendoset nëpunësi në periudhë prove dhe me përfundimin e afatit të periudhës së provës, të kryejë vlerësimin e rezultateve individuale në punë për periudhën e provës.
- Vlerësimi i rezultateve individuale në punë për periudhën e provës, bëhet sipas procedurave të përcaktuara në aktin nënligjor për vlerësimin e arritjeve vjetore. Por, në rastin e vlerësimit për periudhën e provës, periudha e vlerësimit fillon nga data e aktit të emërimit dhe zgjat një vit. Për këtë arsye, në formularin e vlerësimit të punës, në “Ndarja

A”, duhet të përzgjidhet rasti “Tjetër (specifiko)” dhe të shënohet “Vlerësim i rezultateve në punë për periudhën e provës”.

- Eprori direkt, pas përfundimit të periudhës së provës, të nxjerrë për nëpunësit në periudhë prove, vendimin e arsyetuar të përmbylljes së procesit të konfirmimit. Gjatë arsytimit të vendimit nga eprori direkt, duke përfshirë evidentimin e bazës ligjore ku mbështetet procesi, duhet të argumentohet në mënyrë të qartë edhe përmbajtja e procesit, që përfshin datën e fillimit të periudhës së provës dhe plotësimin e detyrimeve të përcaktuara në nenin 24, të ligjit nr. 152/2013, (të përmendet dokumenti i përfundimit të trajnimit të detyrueshëm dhe rezultati i testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit pranë Shkollës së Administratës Publike (ASPA).

VI. Transferimi i përkohshëm dhe transferimi i përhershëm dhe si janë respektuar kërkesat ligjore në këto raste.

- **Transferimi i përkohshëm**

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar gjatë procesit të mbikëqyrjes, vërehet 1 rast i transferimit të përkohshëm, sipas nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Kreut I, të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”.

Bëhet fjalë për nëpunësin *****, i cili me aktin nr. 1155/1 prot., datë 17.02.2017, është transferuar përkohësisht nga pozicioni “*Specialist Jurist*”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në pozicionin “*Specialist*”, në Drejtorinë e Komisioneve Zgjedhore, Trajnimit dhe Edukimit të Zgjedhësve.

Në kuptim të nenit 48, pika 1, germa a), të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se, nëpunësi mund të transferohet, përkohësisht, në një pozicion tjetër të shërbimit civil, të së njëjtës kategori në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë dy viteve, rezulton se nëpunësi *****, për interes të institucionit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është transferuar për një periudhë 6 mujore, në një pozicion tjetër të shërbimit civil, të së njëjtës kategori, me shkresën nr. 1155 prot., datë 17.02.2017, të njesisë përgjegjëse “*Njoftim për transferimin e përkohshëm, në një pozicion tjetër të shërbimit civil, të së njëjtës kategori brenda institucionit*”.

Nga verifikimi i dosjes së personelit, rezulton se, në përputhje me përcaktimet e pikës 4 dhe 5, të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, kërkesa për transferimin e këtij nëpunësi është miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Gjatë periudhës së transferimit të përkohshëm, nëpunësi ***** nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë (rast i cili është trajtuar në mënyrë të hollësishme në kapitullin IV), me vendimin nr. 192 prot., datë 31.03.2017, është emëruar nëpunës civil në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Edukimit të Zgjedhësve”, në Drejtorinë e Komisioneve Zgjedhore, Trajnimit dhe Edukimit të Zgjedhjeve.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se, në zbatim të nenit 51, pika 1, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, nëpunësi në fjalë, për arsye paaftësie shëndetësore për kryerjen e detyrave të pozicionit të punës “Përgjegjës i Sektorit të Edukimit të Zgjedhësve” në Drejtorinë e Komisioneve Zgjedhore, Trajnimit dhe Edukimit të Zgjedhjeve, e vërtetuar nga Komisioni mjekësor kompetent, me raportin mjeko ligjor numër 86511 regjistri, datë 20.09.2017, nëpunësi ka paraqitur kërkesën nr. 5561/1, datë 25.09.2017, nëpërmjet të cilës kërkon transferimin e përhershëm në pozicionin e mëparshëm të punës “Specialist Jurist Prokurimesh”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, i cili rezultonte pozicioni i lirë pune.

Në këto kushte, Drejtori i Burimeve Njerëzore në institucionin e mbikëqyrur, njëkohësisht në rolin e eprorit direkt dhe të njësisë përgjegjëse, pasi ka shqyrtuar rastin në fjalë, me vendim nr. 2, datë 17.10.2017, “Për transferimin e përhershëm të ***** nga pozicioni i punës Përgjegjës i Sektorit të Edukimit të Zgjedhësve në DKZETEZ, në pozicionin Jurist i Prokurimeve”, ka vendosur transferimin e përhershëm në pozicionin aktual të punës “Jurist i Prokurimeve”, për nëpunësin ***** në përputhje me pikën 28, të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, ku parashikohet shprehimisht se : “Për institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore, njësia përgjegjëse merr vendim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës nga eprori direkt dhe vendos për transferimin e nëpunësit brenda institucionit”.

- **Transferimi i përhershëm**

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar gjatë procesit të mbikëqyrjes, vërehet **I rast** i transferimit të përhershëm, sipas nenit 49 dhe 51, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Kreut I, të , të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”.

Bëhet fjalë për nëpunësin ***** , i cili me vendimin nr. 2 datë 02.02.2017, “Për transferimin e përhershëm të ***** nga pozicioni i punës “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Edukimit të Zgjedhësve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në pozicionin “Përgjegjës Sektori i Kërkesave për Informimin”, në institucionin e Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit, në një pozicion tjetër të shërbimit civil”, është transferuar në mënyrë të përhershme nga pozicioni “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Edukimit të Zgjedhësve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në pozicionin “Përgjegjës Sektori i Kërkesave për Informimin”, në institucionin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit, me kërkesën e paraqitur nga ky i fundit.

Nëpunësi është transferuar me transferim të përhershëm për arsye të shmangies së konfliktit të interesit, në detyrën “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Edukimit të Zgjedhësve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Konkluzion: Komisioneri arrin në përfundimin se, procedura e transferimit të përkohshëm si dhe transferimit të përhershëm për nëpunësin ***** , është kryer në përputhje me përcaktimet e nenit 48 dhe 51, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktin nënligjor që rregullon këtë aspekt të ligjit.

Gjithashtu dhe në rastin e nëpunësit ******, janë respektuar kërkesat ligjore dhe përcaktimet e nenit 49, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktit nënligjor që rregullon këtë aspekt të ligjit.

VII. Pezullimi nga shërbimi civil, sipas rasteve të parashikuara në ligj dhe si janë zbatuar kërkesat ligjore gjatë procedurës së zhvilluar në këto raste.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes është konstatuar se, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, procedura e pezullimit nga shërbimi civil është zbatuar në **1 rast** dhe bëhet fjalë për nëpunësen ******, me detyrë “Specialist” në Sektorin e Edukimit të Zgjedhësve, pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Me shkresën nr. 5108 prot., datë 15.07.2017, nëpunësi i ka paraqitur institucionit kërkesën për pezullim e përkohshëm të marrëdhënies në shërbimin civil, për arsye personale. Me vendimin nr. 5284, datë 26.07.2017, është miratuar pezullimi i nëpunëses ****** në bazë të kërkesës së saj për një kohëzgjatje jo më shumë se dy vjet, në varësi të përmirësimit shëndetësor.

Nga verifikimi i procedurave në këtë rast, rezulton se pezullimi është mbështetur në dispozitat ligjore që rregullojnë shërbimin civil, pasi,

- Pezullimi është bërë me kërkesë të nëpunësit civil, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 55, pika 2, dhe vendimit nr. 171, datë 26.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”.

Konkluzion: Në këtë rast, Komisioneri vlerëson se, njësia e burimeve njerëzore të institucionit Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka vepruar drejt në lidhje me procedurën e pezullimit, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 53, pika 1, shkronja “b” dhe vendimit nr. 171, datë 26.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”, Kreu VI, pika 39.

VIII. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore, kërkesa për fillimin e ecurisë, ngritja e Komisionit Disiplinor.

Instituti i disiplinës në shërbimin civil rregullohet në mënyrë të hollësishme në Kreun X, “Disiplina në shërbimin civil”, në nenet 57-61, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Në këtë kapitull përcaktohen në mënyrë specifike përgjegjësia për masat disiplinore, llojet e masave disiplinore, kompetencat dhe procedura për masat disiplinore, parimet për përshkallëzimin dhe individualizmin e masës disiplinore dhe shuarja e masës disiplinore.

Shkelja e detyrimeve që e ngarkojnë me përgjegjësi nëpunësin civil, llojet e shkeljeve dhe masave disiplinore, organi kompetent disiplinor dhe procedurat që duhet të ndiqen në një procedim disiplinor janë të përcaktuara në Kreun X, “Disiplina në shërbimin civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nenet nga 57 deri në 61, në vendimin nr. 115,

datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe udhëzimin nr. 1, datë 02.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “Për elementët kryesorë proceduralë dhe material të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”.

Shkeljet disiplinore shumë të rënda janë përcaktuar në pikën 2, të nenit 57, të ligjit dhe në këtë rast, masa disiplinore që zbatohet ndaj nëpunësit civil, është “*largim nga shërbimi civil*”, i parashikuar në shkronjën “ç” të nenit 58, të ligjit në fjalë.

Në kuadër të mbikëqyrjes, pas verifikimit të dokumentacioni të vënë në dispozicion në lidhje me praktikën e masave disiplinore, që janë aplikuar në institucionin e Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, u konstatuan disa raste të dhënies së masave disiplinore për nëpunësit civilë të këtij institucioni, të cilat paraqiten si më poshtë:

- Për punonjësen *****, e cila kryente funksionet në pozicionin “Përgjegjës Sektor”, në Drejtorinë e Komisioneve Zgjedhore, Trajnimit dhe Edukimit të Zgjedhësve, me vendimin nr. 17 prot., datë 12.10.2015, të eprorit direkt, është marrë masa disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*”.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë procesit të mbikëqyrjes rezulton se, nëpunësja *****, e ka ankimuar vendimin e Komisionit Disiplinor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila e ka pranuar pjesërisht kërkesë padinë dhe çështja është duke u gjykuar nga Gjykata Administrative e Apelit.

- Për punonjësin *****, emëruar në pozicionin “*Specialist*”, në Drejtorinë e Komisioneve Zgjedhore, Trajnimit dhe Edukimit të Zgjedhësve, me vendimin nr. 1371/7 prot., datë 15.03.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është marrë masa disiplinore “*Mbajtje e 1/3 e pagës së plotë për një periudhë gjashtë muaj*”.

Ecuria disiplinore ndaj këtij nëpunësi ka filluar me kërkesë të eprorit direkt të tij, me motivacionin e mos zbatimit haptazi të dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale. Këto shkelje të pretenduara, në zbatim të nenit 57, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, janë konsideruar shkelje të rënda dhe për këtë arsye në zbatim të nenit 59, pika 2, të po këtij ligji, procedimi disiplinor është kryer nga Komisioni Disiplinor, i cili ka kompetencën për shqyrtimin e shkeljeve disiplinore në këtë rast.

Nga verifikimi i akteve administrative, konstatohet se, nëpunësi *****, duke mos qenë dakord me masën disiplinore të marrë nga Komisioni Disiplinor, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, me kërkesë padi, duke kërkuar: “*Shfuqizimin tërësisht të aktit administrativ me nr. 1371/1 prot., datë 23.03.2017, të Komisionit Disiplinor, “Vendim për marrje mase disiplinore “Për mbajtjen e 1/3 të pagës për një periudhë prej gjashtë muaj”.* Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, me Vendim nr. 80-2017-3146, datë 07.18.2017, ka rrëzuar kërkesë padinë, si të pa mbështetur në ligj dhe në prova, duke lënë kështu në fuqi vendimin e Komisionit Disiplinorë për mbajtjen e 1/3 e pagës së plotë për periudhë gjashtë muaj dhe çështja është duke u gjykuar nga Gjykata Administrative e Apelit.

Konkluzion: Në këto rrethana, Komisioneri vlerëson se, për rastin e punonjësve ***** dhe *****, nuk mund të shprehet në lidhje me ligjshmërinë e ecurisë disiplinore, për aq kohë sa kjo çështje do të marrë zgjidhje përfundimtare nga gjykata. Ky qëndrim bazohet në përmbajtjen e nenit 36, paragrafi II dhe III, të Kodit të Procedurave Civile, ku përcaktohet se asnjë institucion nuk mund të trajtojë çështje të cilat po trajtohen ose janë duke u trajtuar nga sistemi gjyqësor, si dhe nga mundësia që i njehtë nëpunësit civil, neni 41, pika 3, e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për t’u ankuar në gjykatën kompetente për mosmarrëveshjet administrative.

IX. Vlerësimi i rezultateve në punë dhe mënyra e realizimit të procesit nga zyrtarët kompetentë.

Vlerësimi i rezultateve në punë të nëpunësve civilë është parashikuar në nenin 62, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Kjo dispozitë parashikon se vlerësimi i rezultateve në punë është një proces që realizohet çdo 6 muaj. Ndërsa në rastin e vlerësimit të rezultateve në punë në përfundim të periudhës së provës, periudha e vlerësimit është një vit dhe llogaritet nga data e emërimit të nëpunësit civil.

Më tej, në vendimin nr. 109, datë 26.02.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, ndryshuar me vendimin nr. 252, datë 30.03.2016, të Këshillit të Ministrave, janë përcaktuar procedurat që duhet të ndiqen për të vlerësuar nivelin e realizimit të objektivave të vendosura, vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit; detyrat e zyrtarëve të përfshirë në procesin e vlerësimit; nivelet e shkallëzuara të vlerësimit si dhe të drejtat e nëpunësit në rastet kur ai nuk është dakord me vlerësimin përfundimtar.

Në kuptim të dispozitave ligjore si më sipër, procesi i vlerësimit të rezultateve në punë është një proces i vazhdueshëm, i cili konsiston në zhvillimin e fazës së planifikimit, në të cilën duhet të identifikohen objektivat kryesore të punës dhe sjelljet profesionale që duhet të përmbushë nëpunësi; zhvillimin e fazës së bisedimeve të ndërmjetme për të vlerësuar progresin e nëpunësit që i nënshtrohet vlerësimit; si dhe në vlerësimin përfundimtar të rezultateve në punë, ku zyrtari raportues, bën një vlerësim të përmbledhur në arritjen e objektivave kryesore të punës për nëpunësin që do të vlerësohet.

Gjatë verifikimit u konstatua se, formularët e vlerësimit të punës janë hartuar sipas formatit të miratuar në Lidhjen nr. 2, pjesë e vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, ku janë materializuar të gjitha rubrikat që kanë të bëjnë me të dhënat personale (ndarja A); të dhënat për kontekstin e punës ku identifikohen objektivat e institucionit dhe të njësisë organizative ku bën pjesë nëpunësi (ndarja B); objektivat dhe matësit e performancës, ku duke mbajtur parasysh përshkrimin e punës, bëhet vlerësimi për çdo objektiv (ndarja C); sjellja profesionale, e cila ka të bëjë me saktësinë në punën e kryer dhe realizimin në kohë, punën në grup e marrëdhëniet me kolegët, shpeshtësinë e orëve të punës jashtë orarit, kërkesën për këshillim, trajnim dhe ngritjen profesionale (ndarja Ç); vlerësimi i përgjithshëm i rezultateve në punë ku bëhet një vlerësim i përmbledhur i arritjes së objektivave kryesore të punës nga nëpunësit.

Në zbatim të programit të kontrollit, për të gjithë nëpunësit që në momentin e mbikëqyrjes vazhdojnë marrëdhënien e punësimit me institucionin, u verifikuan vlerësimet e rezultateve në punë për vitin 2017, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë procesit të mbikëqyrjes, u konstatua se, për shkak të procesit të ristrukturimit të institucionit (*proces që më pas ka ndikuar në raportin hierarkik, duke pasqyruar ndryshimin e zyrtarit raportues për nëpunësin civil që vlerësohet*), nëpunësit e këtij institucioni janë vlerësuar për periudhat si më poshtë:

- a) Vlerësim i pjesshëm për periudhën Janar – Qershor, 2017;
- b) Vlerësim i plotë, për periudhën Janar – Dhjetor, 2017.

Duke pasur parasysh katër nivelet e vlerësimit “shumë mirë”, “mirë”, “kënaqshëm” dhe “jo kënaqshëm”, nga verifikimet e kryera, vlerësimi përfundimtar paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 2: *Niveli i vlerësimit të nëpunësve civilë të institucionit Komisioni Qendror të Zgjedhjeve, për periudhën e vlerësimit Janar-Qershor 2017, për nëpunës që aktualisht ushtrojnë detyrën në institucion.*

Periudha e vlerësimit	Janar – Qershor 2017			
	Shumë mirë	Mirë	Kënaqshëm	Jo kënaqshëm
Numri i nëpunësve civilë	10	15	-	-
Numri i nëpunësve civilë në periudhë prove			8	
Numri i punonjësve të pavlerësuar			0	
Totali			33	

Tabela nr.3: *Niveli i vlerësimit të nëpunësve civilë të institucionit të Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për periudhën e vlerësimit Janar- Dhjetor 2017, për nëpunës që aktualisht ushtrojnë detyrën në institucion.*

Periudha e vlerësimit	Janar – Dhjetor 2017			
	Shumë mirë	Mirë	Kënaqshëm	Jo kënaqshëm
Numri i nëpunësve civilë	15	14		
Numri i nëpunësve civilë në periudhë prove			9	
Nëpunës civilë të vlerësuar për periudhën Korrik-Dhjetor 2017	-			-
Numri i punonjësve të pavlerësuar				
Totali			38	

Konkluzion: Komisioneri arrin në përfundimin se, institucioni i kontrolluar i ka kryer procedurat e vlerësimit të rezultateve në punë sipas përcaktimeve të nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, duke kryer vlerësimin sipas formatit të përcaktuar në Lidhjen nr. 1, të vendimit të sipërcituar.

Nga vlerësimet e dhëna për nëpunësit, konstatohet se ata janë vlerësuar me 2 nivele të procesit, niveli 1, “Shumë mirë”, niveli 2, “Mirë”.

Në këto rrethana, detyrë e zyrtarëve të ngarkuar me këtë proces, duke përfshirë këtu subjektet që e realizojnë atë si dhe njësinë përgjegjëse, mbetet që të sjellë sistemin e vlerësimit të punës, sa më objektiv dhe më afër realitetit, duke përdorur të gjithë spektrin e vlerësimeve, edhe atë që përfaqëson nivelin 3, “Kënaqshëm”, si dhe nivelin më të ulët të vlerësimit, “*jo kënaqshëm*” (4), që përcaktohen në ligj dhe aktin nënligjor.

Realizimi me sukses i këtij procesi ka lidhje me realizimin e detyrave konkrete të nëpunësve, si dhe me zbatimin e procedurave që kërkohen nga ligji dhe aktet nënligjore në këtë rast. Kjo arrihet nëpërmjet trajnimit të të gjithë aktorëve të këtij sistemi, të cilët janë në rolin e nëpunësit autorizues dhe raportues, si dhe disiplinimin e tyre për të mbajtur shënime, për çdo nëpunës civil, sipas afateve ligjore të analizuara më sipër, në pjesën hyrëse të kësaj rubrike.

Sjellim në vëmendje se, vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit civil, synon të përmirësojë aftësitë profesionale të nëpunësve, si dhe të ndikojë në cilësinë e shërbimit të ofruar prej tyre, për këtë arsye, zyrtarët e përfshirë në procesin e vlerësimit, (*Zyrtari raportues/Zyrtari kundërfirmues/Zyrtari autorizues*), duhet ta përfundojnë secilën periudhë të vlerësimit, brenda afateve të parashikuara në vendimin nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për vlerësimin e rezultate në punë të nëpunësve civilë*”, të ndryshuar. Në pikën 12, shkronja “b”, të këtij vendimi është parashikuar që për 6 mujorin e parë të vitit vlerësimi realizohet në periudhën 1-15 korrik dhe për 6 mujorin e dytë të vitit në periudhën 1-15 janar. Më tej në pikën 18 është përcaktuar se “*Jo më vonë se 15 ditë nga data e përfundimit të procesit të vlerësimit të rezultateve në punë, njësia e burimeve njerëzore e institucionit detyrohet të përfshijë në Regjistrin Qendror të Personelit formularin e vlerësimit për çdo nëpunës civil*”.

Në këtë subjekt, nuk konstatohen raste të mosmarrëveshjeve ndërmjet zyrtarëve që realizojnë këtë proces (*Zyrtari raportues dhe/ose Zyrtarëve kundërfirmues dhe autorizues*), lidhur me nivelet e vlerësimit, për shkak të pretendimeve të nëpunësit lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë.

X. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirimit nga shërbimi civil, si rezultat i dorëheqjes dhe për shkak të ligjit.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, për periudhën objekt mbikëqyrje, në institucionin e kontrolluar, u konstatuan **6 raste**, të përfundimit të marrëdhënies së punës në shërbimin civil.

Në 4 raste, nëpunësit janë liruar nga shërbimi civil, për arsye të dorëheqjes, përcaktuar në nenin 64 dhe 66, pika 1, germa “dh”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ku bëhet fjalë për nëpunësit:

- ***** , në pozicionin “*Specialist*”, në Drejtorinë e Teknologjisë dhe Informacionit, liruar me aktin nr. 20, datë 20.11.2015, “*Për lirim nga shërbimi civil*”;
- ***** , në pozicionin “*Specialist*”, në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Jashtë, liruar me aktin nr. 9, datë 30.06.2014, “*Për lirim nga shërbimi civil*” ;

- ***** , në pozicionin “*Specialist*”, në Drejtorinë e Komisioneve Zgjedhore, Trajnimit dhe Edukimit të Zgjedhësve, liruar me aktin nr. 1, datë 12.04.2016, “*Për lirim nga shërbimi civil*” ;
- ***** , në pozicionin “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Shërbimeve dhe Logjistikës Zgjedhore, liruar me aktin nr. 8, datë 08.04.2014, “*Për lirim nga shërbimi civil*” ;

Në 2 raste, nëpunësit janë liruar nga shërbimi civil për shkak të ligjit (*nëpunësit kanë mbushur moshën e pensionit të plotë të pleqërisë*), përcaktuar në Kreut XII, “*Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil*”, nenit 65, të pikës 1, germa c), të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ku bëhet fjalë për nëpunësit:

- ***** , në pozicionin “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Teknologjisë dhe Informacionit, liruar me vendimin nr. 9, datë 29.01.2018;
- ***** , në pozicionin “*Specialist*”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, liruar me vendimin nr. 10, datë 29.01.2018.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, nga njësia e burimeve njerëzore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është vepruar në mbështetje të kërkesave të nenit 65 dhe 66, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, në lidhje me lirimin nga shërbimi civil për shkak të mbushjes së moshës së pensionit si dhe të dorëheqjes.

XI. Organizimi i dosjes dhe Regjistrit Qendror të Personelit

a. Dosja e personelit

Në zbatim të programit të mbikëqyrjes, u këqyrën dosjet e personelit, për të verifikuar nëse ato janë krijuar dhe administrohen në përputhje me kërkesat e nenit 17, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe kërkesave të vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*”.

Nisur nga përmbajtja e dispozitave ligjore si më lart, në dosjen individuale të çdo nëpunësi civil, duhet të jenë të përfshira dokumente me të dhënat personale të karakterit teknik, profesional, si dhe të dhëna të tjera sipas lidhjes 1 dhe 2, bashkëlidhur aktit nënligjor, që rregullon në mënyrë specifike këtë aspekt.

Më konkretisht, në dosjet personale të nëpunësve, duhet të administrohet dokumenti i identifikimit (*fotokopje e letërnjoftimit*); dokumenti mbi gjendjen civile (*certifikata e gjendjes familjare*); dokumentet lidhur me nivelin e edukimit arsimor dhe fushën e studimeve (*fotokopje e noterizuar e diplomës së shkollës së lartë dhe lista e notave*); dokumentet që vërtetojnë fillimin e marrëdhënies të punës në pozicionin përkatës (*akti i emërimit*); aktet që provojnë procesin e deklarimit të statusit të punësimit; aktet që vërtetojnë gjendjen gjyqësore, apo vërtetimi i gjendjes shëndetësore (*Raporti Mjekësor*).

Konstatohet se në dosjet individuale të nëpunësve nuk ka mangësi dhe ato janë të sistemuara dhe ruhen në kushte të përshtatshme në ambientet e institucionit dhe administrohen nga Drejtori i

Burimeve Njerëzore, i cili është nëpunësi përgjegjës për menaxhimin e burimeve njerëzore, në kuptim të Kreut I, pika 4, të vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

Nga grumbullimi i të dhënave, konstatohet se në momentin e mbikëqyrjes, sipas strukturës aktuale (miratuar me vendimin nr. 168, datë 24.04.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e KQZ-së nr. 110, datë 12.09.2002 “Për miratimin e strukturës, organikën dhe numrin e punonjësve të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”, në institucionin e mbikëqyrur ka gjithsej **71** pozicione pune të miratuara, nga të cilat **45 pozicione pune janë pjesë e shërbimit civil**, ku gjendja e pozicioneve të punës rezulton si më poshtë:

- ✓ **41** pozicione të plotësuara
- ✓ **4** pozicione janë të lira

Bëhet fjalë për pozicionet e punës:

- “Përgjegjës Sektori, në Sektorin për Kontrollin Financiar të Partive Politike”;
- “Drejtor në Drejtorinë e Teknologjisë dhe Informacionit”;
- “Specialist në Drejtorinë e Teknologjisë dhe Informacionit”;
- “Specialist/Jurist në Drejtorinë Juridike”.

Referuar të dhënave të mbledhura në bazë të dosjeve personale për **41** nëpunës civilë të institucionit të kontrolluar, të dhënat statistikore paraqiten si më poshtë:

- ✓ **29** nëpunës civilë janë të gjinisë femërore;
- ✓ **12** nëpunës civilë janë të gjinisë mashkullore;
- ✓ Moshë mesatare e femrave është afërsisht 28 vjeç;
- ✓ Moshë mesatare e meshkujve është afërsisht 41 vjeç;
- ✓ Moshë mesatare e numrit total të nëpunësve civilë është afërsisht 35 vjeç;

Njëkohësisht, rezulton se të gjithë nëpunësit civilë të institucionit të Komisioni Qendror të Zgjedhjeve, kanë diplomë të studimeve të larta universitare, në institucione të ndryshme të arsimit të lartë, situatë e cila paraqitet si më poshtë:

- ✓ **34** nëpunës civilë zotërojnë diplomë të marrë nga universitetet publike të Republikës së Shqipërisë;
- ✓ **6** nëpunës civilë zotërojnë diplomë të marrë nga universitetet private të Republikës së Shqipërisë;
- ✓ **1** nëpunës civil zotëron diplomë të marrë jashtë vendit, të njohur nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve.

Konkluzion: Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, dosjet e personelit janë të organizuara dhe të plotësuara në përputhje të plotë me përcaktimet e nenit 17, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

b. Regjistri i personelit

Regjistri i personelit është një dokument që duhet të krijohet sipas kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, dhe Vendimit nr. 117, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

Mbështetur në dispozitat ligjore si më sipër, Regjistri Qendror i Personelit, krijohet dhe administrohet nga Departamenti i Administratës Publike.

Në momentin e realizimit të mbikëqyrjes, u konstatua se, në institucionin e mbikëqyrur ka përfunduar procesi i hedhjes së të dhënave në Regjistrin Qendror të Personelit.

*
* *

Këto ish-in rrethanat e konstatuara gjatë procesit të mbikëqyrjes në institucionin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në lidhje me veprimet administrative të kryera nga njësi përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, prej momentit të fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Aktet administrative që dokumentojnë procesin e mbikëqyrjes në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, sipas pikave të këtij raportit, janë materializuar në anekset si më poshtë:

Aneksi nr. 1: “Akte që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” (data 26.02.2014)”,

Aneksi nr. 2: “Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas ligjit dhe i kërkesave të posaçme sipas formularit të përshkrimit të punës, për punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve”.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA